

METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË TARIFËS PER SHËRBIMIN E RIGAZIFIKIMIT NGA IMPIANTET E GNL-s NE SHQIPERI

Neni 1 Qëllimi

1.1 Kjo metodologji përcakton kriteret, kushtet dhe mënyrën e llogaritjes së tarifave për shërbimin e rigazifikimit të realizuar nga impiantet e GNL-së.

Neni 2 Fusha e zbatimit

2.1 Kjo metodologji do të zbatohet për subjektet e Sistemit të GNL-së, të cilët janë persona juridikë, të licencuar nga ERE, dhe ;

- a) i përkasin sistemit kombëtar të gazit siç përcaktohet në nenin 4 pika 17 të Ligjit 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror,” i ndryshuar, dhe operojnë, mirëmbajnë e zhvillojnë nje impiant GNL-je.
- b) ose kanë marrë miratimin për përdorimin e impianteve ekzistuese të sistemit, në përputhje me Nenin 11 dhe Nenin 69 të Ligjit 102/2015;
- c) u nënshtrohen rregullave të përgjithshme për aksesin dhe sigurimin e shërbimit të rigazifikimit nga impiantet e GNL, sipas dispozitave të ligjit 102/2015 (Nenet 68 - 74) për Sektorin e Gazit Natyror, i ndryshuar
- d) impianti i GNL-së është i lidhur me Sistemin e Transmetimit
- e) shkarkon dhe rigazifikon GNL-në, sipas kontratave të nënshkruara;

Neni 3 Përkufizime

“Rigazifikim” është procesi i ngrohjes së GNL-së deri në kthimin e tij në gjendje të gaztë.

“Impiant GNL-je” është terminali që përdoret për lëngëzimin e gazit natyror ose importin, eksportin, shkarkimin apo rigazifikimin e GNL-së, përfshirë shërbimet ndihmëse dhe depozitat e përkohshme, të nevojshme për procesin e rigazifikimit dhe lëvrimin e mëtejshëm në sistemin e transmetimit, pa përfshirë pjesët e terminaleve të GNL-së, që përdoren për depozitim.

“Metodologji e tarifave” është akti që përcakton kushtet dhe mënyrën e llogaritjes së tarifave të veprimtarive të rregulluara të gazit natyror.

DRAFT

“**Tarifë**” është çmimi i shërbimit të ofruar nga subjektet që kryejnë veprimtari të rregulluara në transmetimin dhe shpërndarjen e gazit natyror, dhe **impjantet e GNL-së**, i vendosur në bazë të metodologjisë së llogaritjes së tarifave

“**Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB)**” është vlera e asetëve fikse në pronësi të operatorit të GNL-se që përdoren për të siguruar shërbim e hyrjes dhe rigazifikimit në impjantet e GNL.

“**Periudha rregullatore**” është periudha për të cilën tarifatat e reja hyjnë në fuqi dhe rregullohen sipas vendimit të marrë nga Enti Rregullator i Energjisë, pas një shqyrtimi të plotë dhe të detajuar të aplikimit të tarifave të paraqitura nga operatori i GNL-së

“**Faktori i përmirësimit të efikasitetit (faktori X)**” është përqindja vjetore e reduktimit në koston e shërbimit të lëngëzimit të gazit natyror, që rezulton nga përmirësimet, efikasiteti i shërbimit dhe përmirësimet në teknologji.

“**Operator i sistemit të GNL-së**” është subjekti, i cili kryen veprimtarinë e lëngëzimit të gazit natyror ose importin, eksportin, shkarkimin e rigazifikimit të GNL-së dhe është përgjegjës për operimin e impjantit të GNL-së

“**QCP**” është koeficienti i shprehur në përqindje për të mbuluar vetëkonsumin dhe humbjet në procesin e rigazifikimit/lëngëzimit.

Neni 4

Parimet e vendosjes së Tarifave

- Përcaktimi i tarifave sipas kësaj metodologjie do të bazohet në metodën RoR. Operatorit të rrjetit do t'i lejohet të mbulojë kostot e justifikuara për rrjetin si dhe një kthim mbi investimin.
- Operatori i shërbimit të GNL do të zbatojë rregullat e kësaj metodologjie për qëllimin e përcaktimit të tarifave nga ERE.
- ERE do të miratojë tarifatat e rrjetit kur të plotësohen kushtet dhe parimet e kësaj metodologjie.
- Tarifatat e përdorimit të rrjetit të aprovuara nga ERE do të jenë të vlefshme për një periudhë ushtrimore (1 vjeçare), për periudhën e parë rregullatore, si dhe do të jenë në përputhje me periudhën rregullatore të zbatuar për operatorët e rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes.
- Shmangia nga çdo parashikim i kësaj metodologjie do të çojë në refuzimin nga ERE të aplikimit për tarifë të operatorit të GNL
- Tarifatat e rrjetit do të llogariten dhe miratohen nga ERE në bazë të kostove të arësyeshme që operatori i GNL përdor për realizimin e aktivitetit dhe që janë në përputhje me këtë metodologji.

DRAFT

- Kostot dhe tarifat e shërbimit do të llogariten në bazë të të dhënave të përfituara nga viti i mëparshëm i aktivitetit të operatorit të rrjetit , por mund të merret parasysh edhe informacioni i përfituar në vitin aktual, në rast se vlerësohet i besueshëm.
- Tarifat e rrjetit do të pasqyrojnë kostot e shërbimit.
- Tarifat e rrjetit do të llogariten në mënyrë të tillë që, në fund të periudhës rregullatore, diferenca ndërmjet kostove reale të shërbimit (të ardhurave të realizuara) dhe atyre të lejuara nëpërmjet tarifës të jetë sa më e vogël.
- Tarifat e rrjetit duhet të japin sinjalet e duhura për përdorimin me efikasitet të faciliteteve të GNL.
- Shpenzimet e lejuara në tarifë duhet të jenë transparente për të gjithë përdoruesit
- Tarifat e shërbimit të GNL-së duhet t'i lejojnë operatorit të përfitojë normën e lejuar të kthimit mbi bazën e rregulluar të aseteve të miratuar nga ERE.

Neni 5

Të ardhurat e kërkuara për shërbimin të rigazifikimit dhe GNL

5.1 Të Ardhurat e Kërkuara llogariten çdo vit dhe përfshijnë kostot e operimit dhe kapitalit (amortizimi dhe kthimi mbi kapitalin) të aktivitetit përkatës dhe llogaritet duke përdorur të dhënat e kontabilitetit.

5.2 . Të ardhurat e kërkuara për mbulimin e shërbimit të rigazifikimit dhe GNL (**RR**) për çdo vit të periudhës rregullatore, do të jenë të barabarta me shumën e pjesëve të të ardhurave për të mbuluar:

- a) Kthimin mbi kapitalin të investuar neto të njohur nga rregullatori,
- b) stimuj për zhvillimin e kapacitetit të ri të rigasifikimit
- c) amortizimin ekonomiko-teknik
- d) kostot e njohura të operimit (OPEX), për mirëmbajtjen e menexhimin e terminalit, në përputhje me nenin 7 më poshtë;
- e) kostot në lidhje me energjinë elektrike për funksionimin e terminalit
- f) Kostot për mbulimin e sasisë së GNL-së të nevojshme për të mbuluar vetëkonsumin dhe humbjet në procesin e rigasifikimit dhe çdo sasi të energjisë elektrike të nevojshme për të mbuluar konsumin e zinxhirit të rigasifikimit,
- g) Komponenti që mbulon kostot në lidhje me sistemin e tregimit të emëtimit, nëse do të jetë i aplikueshëm
- h) Komponenti për të mbuluar kostot e restaurimit,
- i) Te ardhurat e zbriteshme të vitit **t-2**
- j) Rregullime të periudhave të ndryshme në periudhen **t**

Neni 6 Kthimi në Kapitalin e Investuar

6.1 Njohja e vlerës së aseteve fikse bëhet me kusht që investimet përkatëse të jenë në përputhje me efikasitetin dhe sigurinë e sistemit dhe të bëhen në përputhje me kriteret e ekonomike

6.2 Për qëllimin e përcaktimit të kapitalit të njohur neto të investuar për vitin e testimit për kompaninë e rigazifikimit, GNL:

- a) llogaritet vlera e aseteve fikse neto në përputhje me paragrafin 4.3;
- b) Shtohet vlera e kapitalit të punës neto, të vendosur sa 1/12 e OPEX-it
- c) Zbritet vlera e të ardhurave të tjera, si ato nga dëmshpërblimet
- d) zbritet vlerën e granteve kapitale të disbursuara në çdo vit nga organet publike ose private për ndërtimin e infrastrukturës

6.3 Për qëllimin e përcaktimit të vlerës së aseteve fikse neto për operatorin e GNL do të konsiderohet :

- a) vlera e mbetur e aseteve fikse të trupëzuara të nevojshme për operimin e GNL të llogaritura me koston historike të blerjes apo prodhimit në fillim të periudhës rregullore në vitin **(t-2)** (pas zbritjes së shumës së amortizimit të aseteve)
- b) Identifikohen rritjet vjetore të kapitalit në lidhje me shërbimin e rigazifikimit/ GNL të kompanisë së rigazifikimit në lidhje me asetet fikse që janë në punë në 31 dhjetor të vitit **t -1**
- c) Shtesat e reja të investimeve që parashikohen të realizohen në vitin **t**
- d) Llogaritet vlera e amortizimit, sipas metodës së jetëgjatësisë së asetit, që buron nga shuma e produkteve të rritjeve të kapitalit të përmendura në pikën b dhe c për përqindjet përkatëse të amortizimit.
- e) RAB do të llogaritet si shumatore e komponenteve të mësipërme (a + b+c -d)

6.4 Për qëllimet e përcaktimit të vlerës së aseteve fikse neto, merren parasysh si më poshtë:

- a) kostot në lidhje me gazin ftohes/mbushës, i cili shërben si rezervë dhe është i domosdoshëm nga ana teknologjike për të mundur realizimin e rigazifikimit do të përcaktohet i barabartë me vlerën e blerjes që rezulton nga procedurat që respektojnë parimin e efektivitetit të koston të investimeve të bëra; ose kosto mund të përcaktohet në bazë të mesatares së **Çmimit Mesatar të Sistemit** minus koston e transportit, e regjistruar në periudhën në të cilën GNL-ja e nevojshme për mbushje është dorëzuar në terminalin e rigazifikimit;

DRAFT

- b) kostot në lidhje me gazin ftohës, të përcaktuara në bazë të kritereve të referuara në shkronjën e mësipërme a); janë subjekt i amortizimit dhe përfshihen në kategorinë e asetëve të impiantit të GNL-së.

6.5 Për qëllimin e llogaritjes së vlerës së rritjes së kapitalit referuar në pikën e mësipërme pika b) çdo shpenzim i interesit në progres e përlllogaritur pas hyrjes në operim të asetit do të konsiderohet si rritje e kapitalit, çdo kosto financimi të kapitalizuar sipas pranimit dhe miratimit paraprak si kosto e arsyeshme nga ERE.

6.6 Kompania e rigazifikimit që kryen shërbimin e rigazifikimit përmes infrastrukturave në pronësi të subjekteve të ndryshme, llogarit të ardhurat e referencës duke marrë parasysh, për qëllime të llogaritjes së aktiveve fikse, të dhënat nga pasqyrat financiare të këtyre subjekteve.

6.7 Gjatë periudhës rregullatore pas vitit të testimit, pjesa e të ardhurave që mbulon kthimin e kapitalit të njohur të investuar përditësohet duke marrë parasysh:

- a) investimet e hyra në operim gjatë vitit paraardhës të vitit të paraqitjes së propozimit tarifor;
- b) investimet që pritet të hyjnë në operim në vitin e prezantimit të propozimit të tarifave në bazë të rezultateve paraprake;
- c) grante për shpenzime kapitale të marra për realizimin e investimeve;
- d) rritjen e amortizimit në bazë të jetëgjatësisë të asetëve fikse .

6.8 Kthimi i lejuar mbi kapitalin pas taksave do të merret norma bazë e interesit si dhe një premium për riskun specifik të operatorit të GNL-SE t. Norma bazë e interesit merret vlera mesatare 5 vjeçare e mesatares së ponderuar të obligacioneve qeveritare të publikuara nga Banka e Shqipërisë.

Kthimi mbi kapitalin pas taksave do të vendoset nga ERE.

Herën e parë, ky vendim duhet të merret dhe të publikohet në fillim të vitit në të cilin operatorët fillojnë aktivitetin dhe në vazhdim, çdo tre vjet.

Neni 7 Amortizimi i lejuar

7.1 Për qëllimet e përcaktimit të amortizimit të lejuar për vitin **t**, kompania e rigazifikimit/GNL:

- a) llogarit asetet fikse bruto të kategorive individuale të asetëve në operim deri më 31 dhjetor të atij viti

DRAFT

- b) zbrit nga asetet fikse bruto të kategorive individuale të aseteve të perftuara nëpërmjet granteve;
- c) përcakton amortizimin vjetor si një raport i vlerës së përmendur në shkronjën b), për secilën kategori të asetit, ndaj jetëgjatësisë së asetit ose jeëgjatësisë së përcaktuar nga Rregullatori.
- d) shton amortizimin vjetor të përmendur në shkronjën c) amortizimit të akumuluar për periudhat paraardhëse.

Neni 8

Kostot operative

8.1 Pjesa e të ardhurave për të mbuluar kostot operative përcaktohet, për vitin kur Rregullorja të jetë e aplikueshme nga shoqëritë, në bazë të kostove operative të bëra realisht nga kompanitë e rigazifikimit/ GNL. Kostot aktuale të operimit përfshijnë të gjithë artikujt e kostove të një natyre të përsëritur, të ndodhura realisht i atribuohen shërbimit të rigazifikimit dhe GNL dhe përcaktohen në bazë të llogarive vjetore sipas Pasqyrave Financiare.

8.2 Në rast të diferencave të konsiderueshme të tepërta ndërmjet zërave të artikujve të kostos të kerkuar për periudhën rregullatore t dhe atyre të ndodhura në vitet e mëparshme, dhe ku nuk justifikohen nga kompania e rigazifikimit/GNL, kostot aktuale të funksionimit, do të përcaktohen bazuar në një mesatare të këtyre kostove në vitet e mëparshme duke përjashtuar ato kosto që nuk kanë natyrë -përsëritëse dhe që nuk janë të argumentuara.

8.3 Me kosto aktuale kuptojmë kostot direkte të operimit (kostot e personelit dhe ato materiale), kostot indirekte të operimit (mirëmbajtje, shërbime, riparime dhe të tjera) si dhe shpenzime të përgjithshme (qira, siguracione dhe kosto energjie dhe të tjera). ERE do të vlerësojë nëse këto kosto janë të arsyeshme dhe të justifikuara.

8.4 Në rast se kostot aktuale të funksionimit të përcaktuara në përputhje me paragrafët e mësipërm, janë më të ulëta ose me te larta se sa kostot operative të njohura, atëherë pjesa e të ardhurave të rregulluara do të jenë të korigjueshme / rregullueshme për periudhën e ardhëshme rregullatore.

8.5 Në rastet kur periudha rregullatore është disa vjecare atëherë zërat e OPEX-it për vitet pas vitit bazë do të korigjohen si më poshtë :

Për vitin e dytë të ciklit të vlerësimit të tarifave (Viti 2), tarifa mesatare e transmetimit për vitin bazë shumëzohet me faktorin vjetor të rregullimit:

$$A = (1 + RPI - X)$$

A është faktori i rregullimit vjetor

RPI është norma e inflacionit për çmimet e konsumit e parashikuar për Vitin e 2-të nga Banka e Shqipërisë ose INSTAT

- ERE do të përcaktojë edhe faktorin X e cila do të përcaktohet si përqindje vjetore e reduktimit në koston e shërbimit të lëngëzimit të gazit natyror, që rezulton nga përmirësimet, efikasitetin e shërbimit dhe përmirësimet në teknologji.
- Per periudhen e parë rregullatore faktori X do të jetë zero.

8.6 Kompanitë e rigazifikimit mund të paraqesin një kërkesë për aktivizimin e parametrin **Y** për të mbuluar kostot që rezultojnë nga ngjarje dhe ndryshime të jashtëzakonshme dhe të paparashikueshme nga Rregullatori. Kompanitë duhet të demonstrojnë se këto kosto janë në rritje krahasuar me kostot aktuale të konsideruara në vitin bazë, po ashtu dhe për paparashikueshmërinë aktuale dhe natyrën e jashtëzakonshme të ngjarjeve të konsideruara; dhe të demonstrojnë çdo aktivitet të ndërmarrë, kostot përkatëse në vitin bazë, si dhe aktivitetet shtesë që bëhen të nevojshme në zbatim të ndryshimeve të pritshme, qoftë ato dhe nga ndryshimet e Akteve Ligjore.

Neni 9

Kostot elektrike për operimin e impiantit

9.1 Pjesa e të ardhurave për të mbuluar kostot në lidhje me energjinë elektrike për funksionimin themelor të terminalit përcaktohet si më poshtë:

- a) për impiantet që janë të lidhur në rrjetin elektrik, në bazë të:
 - i. konsumit vjetor të energjisë elektrike, i përcaktuar duke filluar nga fuqia mesatare e përdorur për funksionimin bazë;
 - ii. vlerësimin të sasive të energjisë elektrike të përmendura në pikën i) më lart me çmimin e paguar në vitin e fundit të vitit të fundit në dispozicion (**t-2**);
- b) për terminalet që nuk janë të lidhur në rrjetin elektrik, në bazë të:
 - i. konsumit vjetor të energjisë elektrike, i përcaktuar duke filluar nga fuqia mesatare e përdorur për funksionimin bazë;
 - ii. sasinë e GNL-së të nevojshme për vetë-prodhimin e energjisë elektrike të përmendura në pikën i) më lart, duke marrë parasysh efikasitetin e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike në terminal;
 - iii. vlerësimi i sasive të GNL-së të përmendura në pikën ii) më sipër me çmimin mesatar të ponderuar të energjisë në vitin tarifor referues.

DRAFT

9.2 Çdo devijim midis çmimeve të njësisë të konsideruara për qëllimet e vlerësimeve të referuar në paragrafin e mëparshëm, shkronja a) dhe shkronja b) , dhe çmimet e sakta të regjistruara do të konsiderohen në përcaktimin e këtij zëri të kostos në vitin e referencës (**viti t**) konsiderohen për qëllimet e përcaktimit të pjesës së të ardhurave për të mbuluar kostot e energjisë elektrike për funksionimin themelor të terminalit që lidhet me vitin **t + 2**.

Neni 10

Konsumi teknologjik dhe humbjet në procesin e rigazifikimit

10.1 Kompanitë e rigazifikimit/lëngzimit, duke iu referuar kushteve operative të funksionimit të terminalit të parashikuar dhe, kur është e mundur, për të dhënat historike, përcaktojnë:

- a) sasi të GNL-së të nevojshme për të mbuluar vetëkonsumin dhe humbjet në procesin e rigazifikimit;
- b) çdo sasi e energjisë elektrike e nevojshme në procesin e rigazifikimit

10.2 Sasi të GNL-së të referuara në paragrafin 10.1, germa a), përdoren për qëllimin e përcaktimit të përbërësit të QCP.

10.3 Sasi të energjisë elektrike të referuara në paragrafin 9.1, shkronja b), janë vlerësuar sipas, dhe e përdorur për qëllimin e përcaktimit të tarifës së njësisë CCP. Çdo devijim midis këtij vlerësimi dhe çmimeve të regjistruara në të vërtetë në vitin e referencës (**viti t**) konsiderohen për qëllime përcaktimi i tarifës së CCP për vitin **t + 2**.

10.4 Çdo ndryshim midis sasive të referuara në paragrafin **10.1** dhe sasive të regjistruara në të vërtetë në vitin referues (**viti t**) konsiderohen për qëllimet e përcaktimit të sasive për vitin **t + 2**.

10.5 Përjashtimisht, nëse menaxhimi i devijimeve të përmendura në paragrafin e mëparshëm nuk është në përputhje me kushtet teknike-operacionale të terminalit të rigazifikimit, raporton menjëherë tek Autoriteti, i cili rezervon të drejtën të ndërhyjë duke lejuar shitjen ose blerjen e sasi të nevojshme të gazit. Shumat në lidhje me shitjen ose blerjen e sasive të nevojshme të GNL-së shlyhen në "llogarinë e shpenzimeve të impiantit të rigazifikimit".

Neni 11

Mbulimi i konsumit dhe humbjeve të zinxhirit të rigazifikimit

11.1 Kompanitë e rigazifikimit aplikojnë, për sasi të GNL-së të shkarkuar nga përdoruesi i impiantit;

DRAFT

- a) koeficientin QCP për të mbuluar vetëkonsumin dhe humbjet në zinxhirin e rigazifikimit, shprehur në terma përqindje;
- b) tarifën e njësisë CCP për të mbuluar kostot monetare të shoqëruara me konsumin e zinxhirit të rigazifikimit, shprehur në euro/metër kub GNL të lëngshëm/vit.

11.2 Koeficienti i QCP , përcaktohet duke iu referuar kushteve të pritshme të funksionimit të terminalit dhe të dhënave historike, aty ku janë të disponueshme.

11.3 Tarifa për njësinë e CCP përcaktohet si raport midis vlerësimit të sasive të energjisë elektrike të përdorur për procesin e rigazifikimit/lëngëzimit dhe sasive të GNL që pritet të shkarkohen duke iu referuar kushteve të funksionimit të terminalit të parashikuar për sasinë e të njëjtit komponent dhe të dhënave historike, aty ku ka informacion të disponueshëm.

Neni 12

Investimet e reja lidhur me shtesat e kapacitetit të rigazifikimit

12.1 Dispozitat e këtij Neni do të zbatohen për impiantet e reja dhe ato ekzistuese në rast të rritjes së kapacitetit të tyre më shumë se 30%.

12.2 Për qëllimet e njohjes së investimeve të bëra në të ardhurat e kerkuara operatorit të GNL i cili parashikon të ndërtojë një kapacitet të rigazifikimit u kërkohet të paraqesë një analizë kosto-përfitim të investimit tek ERE, të zhvilluar në përputhje me kriteret e përgjithshme në metodologjitë e aplikuara në nivelin evropian dhe kombëtar dhe duke marrë parasysh udhëzimet e përcaktuara nga aktet rregullatore për vlerësimin e ndërhyrjeve të zhvillimit të rrjetit të transportit të gazit natyror.

ERE pas vlerësimeve të këtyre investimeve do të vendosë nëse do të pranojë ose jo pëfshirjen e tyre në tarifë në mënyrë që të sigurojë qëndrueshmëri midis nivelit të shërbimit të kryer dhe nivelit të kthimit të njohur.

12.3 Për qëllime të llogaritjes së të ardhurave referuese për vitin e parë të shërbimit të rigazifikimit **t**, kompanitë llogarisin pjesët vjetore të të ardhurave në lidhje me kthimin e kapitalit neto të investuar dhe amortizimin ekonomik-teknik sipas kriterëve të treguara Nenin X dhe Nenin XX, bazuar vlerës së rritjes së kapitalit në lidhje me asetet fikse në operim të reflektuara në pasqyrat financiare për vitin në të cilin është paraqitur propozimi për tarifa për periudhën **t-1**.

12.4 Pjesa e të ardhurave vjetore që i atribuohen kostove operative:

- a) për vitin e parë të ofrimit efektiv të shërbimit të rigazifikimit, të ardhurat e kerkuara

DRAFT

propozohen nga kompanitë dhe i nënshtrohen verifikimit nga ERE. Ky propozim duhet të përfshijë një krahasim me realitete të ngjashme ose dëshmi të që provojnë përpjekjet për minimizimin e kostove si dhe:

- i. dallimin, për secilin artikull të kostos operative, midis kostove fikse dhe variabile,
 - ii. çdo dallim midis kostove operative që i atribuohen drejtpërdrejt funksionimit impiantit dhe kostove administrative dhe strukturore;
- b) për vitet e periudhës rregullatore pas fillimit të ofrimit të shërbimit, përcaktohet duke filluar nga vlerësimi i propozuar nga ndërmarrjet dhe, duke filluar nga disponueshmëria e të dhënave përfundimtare në lidhje me kostot aktuale të funksionimit që mund të nxirren nga Pasqyrat Financiare që përfaqëson një vit të plotë, bazuar në pasqyrat financiare të audituara për vitin e kaluar dhe llogaritë e unifikuara të paraqitura në përputhje me rregulloren perkatëse .

12.5 Në rast se ofrimi i shërbimit fillon gjatë vitit, vlera e të ardhurave të njohura përcaktohet në përputhje me ditët në të cilat shërbimi vihet në dispozicion në të vërtetë.

Neni 13

Mekanizmi i barazimit për menaxhimin e mospërputhjeve midis të dhënave përfundimtare dhe paraprake të bilancit

13.1 Kompanitë e rigazifikimit gjatë procesit të aplikimit për tarifë duhet të paraqesin diferencat në të ardhurat e kerkuara që rezultojnë nga pasqyrat financiare me të ardhurat e lejuara, rezultatet paraprake në lidhje me vitin **t-1**. Këto diferenca në (+) ose (-) që vijnë nga periudhat e mëparshme rregullatore do të konsiderohen si të arësyeshme dhe do të përfshihen në të ardhurat e kerkuara të periudhës që rishikohet **t**.

Neni 14

Tarifa për shërbimin e rigazifikimit

14.1 Tarifa për aksesin në kapacitetin e rigazifikimit në baza vjetore, TL, përcaktohet nga formula e mëposhtme:

$$TL=(C_{QS} + C_{RS}) * QS$$

Ku:

C_{QS} - është tarifa e angazhimit për njësi e lidhur me sasinë kontraktuale të GNL, e shprehur në euro / metër kub të GNL të lëngshme/vit;

C_{RS} - është tarifa për njësi për të mbuluar kostot e restaurimit, të shprehura në euro / metër kub të lëngët GNL / vit.

QS - janë sasi të kontraktuale të GNL-së të kryera gjatë vitit, të shprehura në metra kub GNL të lëngshëm / vit.

14.2 Tarifa e njësisë C_{QS} është e barabartë me raportin midis të ardhurave të referencës RL dhe kapacitetit teknik të terminalit.

14.3 Tarifa e njësisë C_{RS} është e barabartë me raportin midis të ardhurave për mbulimin e kostove të rigjenerimit të RLRS dhe kapacitetit teknik të terminalit.

- Për shërbimet e transmetimit të gazit natyror dhe për përdorimin e impiantit të GNL, në respektimin e pritjes, ruajtjes së përkohshme të rigazifikimit dhe injektimit të GNL në Sistemin e Transmetimit, përdoruesit mund të paguajnë nga njëra anë, një shumë për përdorimin e Sistemit të Transmetimit sipas tarifës së publikuar të transmetimit të gazit natyror (këtu e tutje "Tarifa e Transmetimit"), dhe në anën tjetër për përdorimin e Sistemit GNL sipas tarifës së publikuar (këtu e tutje "Tarifa e GNL")
- Duke pasur parasysh nga njëra anë pasigurinë e konsiderueshme në lidhje me shkallën e përdorimit të stacionit terminal GNL në të ardhmen, si pasojë e përdorimit të kapacitetit të instaluar, gjithashtu me rëndësi si dhe për balancimin e ngarkesës së Sistemit të Transmetimit ose me tej krijimin e një pike hyrëse për furnizuesit e rinj në tregun e gazit natyror, i cili mund të ketë një efekt në të ardhurat e Operatorit të Sistemit, për sigurimin e tarifave sa më të qëndrueshme për Përdoruesit e tij, dhe nga ana tjetër rëndësinë e një stacioni të tillë për funksionimin e qetë të Sistemit të Transmetimit dhe sigurinë e furnizimit të vendit, mundet që një pjesë e të Ardhurave të Kërkuara nga GNL të rikuperohen përmes Tarifës së Transmetimit (përkatësisht ato i shtohen të Ardhurave të Kërkuara të Sistemit të Transmetimit). Ky raport do të përcaktohet përgjatë shqyrtimit të tarifës të Sistemit të Transmetimit dhe tarifës së impiantit të GNL për periudhën rregullatore t.

Neni 15

Kriteret e rregullimit të tarifave për depozitat në GNL

15.1 Dispozitat e kësaj **metodologjie** zbatohen gjithashtu për qëllimet e përcaktimit të të ardhurave referuese dhe tarifave për shërbimin e rigazifikimit të GNL të siguruar nga depozitat e GNL të konsideruara strategjike të impianteve funksionale për procesin e rigazifikimit.

Neni 16

Mbulimi i kostove të zakonshme që i atribuohen shërbimeve të depozitave të DGNL

16.1 Në lidhje me infrastrukturën e përmendur në Nenin 2 të cilat ofrojnë njëkohësisht shërbime të depozitimit, përveç shërbimit të rigazifikimit, mbulimi i pjesës së kostove të përbashkëta për aktivitetin e rigazifikimit dhe shërbimet e depozitimit, bëhet në lidhje me mënyrën e menaxhimit të kapacitetit funksional për sigurimin e këtyre shërbimeve veçanërisht:

- a) në rastin e kapacitetit të dedikuar për shërbimet DGNL përveç asaj të autorizuar për sigurimin e shërbimit të rigazifikimit, **një përqindje e të ardhurave** që vijnë nga sigurimi i këtyre shërbimeve, përcaktuar në bazë të kriterëve të kësaj metodologjie, ajo zbritet nga të ardhurat e referencës për shërbimin e rigazifikimit në përputhje me Nenin 3.
- b) në rastin e shërbimeve DGNL ofruara nga kryerja e të njëjtit kapacitet të rigazifikimit dhe, ku qasja në infrastrukturë ndodh me anë të procedurave konkurruese për caktimin e kapaciteteve të kryera, të ardhurat që rrjedhin nga caktimi i rigazifikimit kontribuon në mbulimin e kostove të zakonshme dhe konsiderohet si e ardhur efektive në rast të aplikimit të faktorit korrigjues të të ardhurave.

16.2 Përqindja e përmendur në paragrafin 15.1, shkronja a), përcaktohet në bazë të një pagese të barabartë, ndoshta me 50% të të ardhurave neto të marra nga sigurimi i shërbimeve DGNL, minus kostot që i atribuohen drejtpërdrejt këtyre shërbimeve. Kompania e rigazifikimit, si pjesë e çertifikimit të të ardhurave, referuar në Nenin X me poshtë, ofron veçmas evidencën e të ardhurave të përgjithshme të arritura nga ofrimi i shërbimeve DGNL dhe kostot që i atribuohen drejtpërdrejt këtyre shërbimeve.

Neni 17

Mekanizmat e mbrojtjes së të ardhurave referuese për depozitat e GNL

17.1 Në lidhje me depozitat strategjike të GNL-së është krijuar një mekanizëm për mbulimin e të ardhurave të referencës që i përkasin vetëm shërbimit të rigazifikimit, i cili parashikon:

- a) një nivel mbulimi të barabartë me një vlerë përqindjeje, më të vogël ose të barabartë me 64%, të përcaktuar rast pas rasti nga ERE në bazë të analizës së kosto-përfitimit të paraqitur nga operatori që demonstroi dobinë e kësaj infrastrukture për sistemin e gazit.

DRAFT

- b) një kohëzgjatje prej 4 vitesh duke filluar nga viti i parë në të cilin ofrohet shërbimi i rigazifikimit.

Neni 18 **Aplikimi për tarifë**

18.1 Bazuar në këtë metodologji, Operatori i impiantit të GNL do të paraqesë në ERE një kërkesë për miratimin e tarifave të reja, jo më vonë se 6 muaj para hyrjes së tyre në fuqi **(t-1)**

18.2 Në aplikim, operatori LNG -se do të paraqesë në ERE të gjithë të dhënat e nevojshme për kostot e impiantit të LNG.

18.3 Pasi të marrë vendimin, ERE do t'ja njoftojë atë, operatorit të rrjetit deri në fund të Nëntorit të atij viti. Operatori i rrjetit i publikon këto tarifa ne faqen e tij të internetit tre ditë pasi është njoftuar. ERE do të publikojë vendimin e saj në faqen e saj të Internetit.

Neni 19 **Kërkesat për Publikun**

19.1 Operatori I GNL është I detyruar të publikojë tarifatat në faqen e tij të internetit si dhe të japë informacion me shkrim të nevojshëm për palët e interesuara.

Neni 20 **Dokumentacioni**

20.1 Me vendosjen e tarifave, operatori i rrjetit do të përgatisë një raport i cili duhet të përmbajë:

- Një përshkrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet për të gjithë periudhën e mbyllur ushtrimore;
- Raporti i plotë i auditimit të pasqyrave financiare si dhe dokumenta të tjera plotësuese.

Të shoqëruara me :

- a) shumën e të ardhurave të referencës Rr;
- b) përbërësit shtesë të të ardhurave nëse rezultojne nga PF
- c) tarifatat e referuara në nenin 14
- d) vlerën e kapacitetit teknik të impiantit
- e) kushtet tekniko-ekonomike për sigurimin e shërbimeve shtesë nëse parashikohet të ketë
- f) konsumin dhe humbjet në procesin e rigazifikimit të regjistruar, në termat e GNL dhe

DRAFT

- mundësisht të energjisë elektrike, gjatë vitit paraardhës dhe përqindjes relative të GNL të shkarkuar në terminal;
- g) konsumi i vlerësuar dhe humbjet e ne procesin e rigasifikimit, në termat e GNL dhe mundësisht të energjisë elektrike, së bashku me detajet e kushteve të pritshme të funksionimit të terminalit, të përcaktuara gjithashtu në bazë të të dhënave historike dhe supozimeve të tjera përkatëse të konsideruara për qëllimet e vlerësimit;
 - h) detajet e kriterëve të përdorura për të bërë ndarjen e mundshme midis:
 - i. sasi të energjisë elektrike ose GNL funksionale për prodhimin e energjisë elektrike për funksionimin themelor të terminalit, duke marrë parasysh fuqinë mesatare të përdorur për funksionimin themelor të terminalit;
 - ii. sasi të energjisë elektrike ose GNL të shoqëruara me konsumin dhe humbjet në procesin e rigasifikimit
 - iii. Listen e llogarive të unifikuara
 - iv. Pasqyrat financiare për vitin e testimit si dhe të periudhës aktuale
 - v. Krahasimin e kostove të lejuara dhe atyre të rezultuara
 - vi. Çdo dokument justifikues të shpezimeve të jashtëzakonshme apo që nuk kanë natyrë përsëritëse.
- Përshkrimi i hollësishëm i ndërhyrjeve të planifikuara dhe kostoja relative të investimeve të ndara sipas kategorisë së asteve
 - Çdo rritje në kapacitetin e rigasifikimit kohët e vlerësuara për realizimin e këtyre investimeve
 - Diferencën midis të ardhurave të lejuara dhe atyre të realizuara në fakt, për të mundësuar korigjimin e të ardhurave në periudhën pasardhëse

Neni 21

Dispozita përfundimtare

21.1 Metodologjia për llogaritjen e tarifave të përdorimit të impianteve të GNL, u miratua me Vendim të Bordit të ERE-s Nr. __ , datë ____2020.